

Nr. Re nd or	Data e regjistrimit	Objekti	Data e kthimit të përgjigjes	Përmbajtja e përgjigjes	Mënyra e përfundimit të kërkesës (E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar)	Tarifa e shërbimit
Periudha Janar 2026						
1	08.01.2026	Kërkohet informacion mbi vlerësimet e punës	20.01.2026	Përrshëndetje z. Ç., Në përgjigje të kërkesës suaj përcjellë nëpërmjet postës elektronike më datë 8.1.2026, me anë të së cilës, në bazë të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, kërkon informacion lidhur me formularët dhe rezultatet e vlerësimeve tuaja të punës, në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë dhe Integritetit Evropian, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Departamenti i Administratës Publike ju informon për sa më poshtë vijon: Nga të dhënat e gjeneruara nga Regjistri Qendror i Personelit (RQP/HRMIS) rezulton se, lidhur me vlerësimin e rezultateve tuaja të punës, në sistem është pasqyruar informacioni sa më poshtë vijon: 1.1.2017 - 7.7.2017 shumë mirë 1.1.2018 - 10.7.2018 shumë mirë 1.1.2019 - 4.7.2019 shumë mirë 1.7.2019 - 31.12.2019 shumë mirë Për periudhat e vlerësimit të lartpërmendura, të dhënat janë hedhur manualisht nga përdoruesi i RQP-së së institucionit punëdhënës, ndërkohë nuk rezultojnë të ngarkuar në sistem formularët respektivë të vlerësimit.	E plotë	Nuk ka

2	18.02.2026	Kërkohet informacion mbi një nëpunës civil	26.02.2026	Përsëritje, Në vijim të kërkesës suaj për informim, Departamenti i Administratës Publike (DAP), bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju sqaron se nga të dhënat që administrojmë rezulton se: Në zbatim të pikave 3-4 të nenit 30 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pikave 7-8, të kreut VII, të vendimit nr. 118, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar, me kërkesë të Ministrit të Financave nr. 2991 prot, datë 18.02.2026, znj. E. L., Anëtare e Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues (TND), është emëruar në pozicionin e nivelit të mesëm drejtues “Drejtore të Drejtoreve Rajonale Tatiore Tiranë”, me aktin e DAP nr. 1003/5 prot, datë 19.02.2026. Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar dhe të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, DAP ka administruar formularin e vetëdeklarimit të dorëzuar nga znj.E. L., në pozicionin e sipërcituar, regjistruar në vijim me numër unik identifikimi 2606 T 0255. Bazuar në detyrimet e parashikuara në ligjin nr. 138/2015, të ndryshuar dhe vendimin nr.17/2016, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, formulari i znj. L. është publikuar dhe ju mund ta aksesoni atë duke ndjekur hapat si më poshtë: Hapi i parë: Regjistrimi dhe hyrja në portalin e-Abania. Klikoni këtu Hapi dytë:Pasi të keni hyrë në sistem në fushën "Kërko Shërbim" , kërkoni "Formulari i Dekriminalizimit" dhe shtypni butonin "PËRDOR" . Hapi i tretë: Plotësoni fushat përkatëse : Emri,Atësia,Mbiemri dhe kodin "CAPTCHA" , në fund shtypni butonin "SHIKO"	E plotë	Nuk ka
---	------------	--	------------	---	---------	--------

3	26.02.2026	Kërkohet informacion mbi thirrjen e ekselencës 2025 e në vijim	09.03.2026	Në vijim të shkresës suaj të datës 25.02.2026, nëpërmjet të cilës kërkon informacion mbi zbatimin e VKM-së nr. 586, datë 30.08.2019, “Per punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore”, i ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike (DAP) ju informon si më poshtë vijon: Procedura e thirrjes së ekselencës për vitin 2024 është shpallur në muajin dhjetor dhe ka vijuar deri në muajin janar 2025, duke përfshirë fazën e aplikimit, të verifikimit të dokumentacionit, përzgjedhjes të kandidatëve dhe finalizimit të lidhjes së kontratave të punës. Përfundimi i këtij procesi në fillim të vitit 2025 ka ndikuar në planifikimin e thirrjes pasardhëse. Gjithashtu, gjatë vitit 2025 janë krijuar ministri të reja, si dhe janë ndërmarrë procese riorganizimi dhe ristrukturimi, të cilat kanë sjellë ndryshime në strukturat organizative dhe në organikat përkatëse. Në këto kushte, institucionet kanë qenë në fazë konsolidimi të strukturave dhe përcaktimi të funksioneve përkatëse. Në këto kushte ka qenë objektivisht i pamundur përcaktimi në kohë të vendeve vakante të cilat do të përfshiheshin në thirrjen për vitin 2025. Në funksion të garantimit të një procedure të rregullt, të barabartë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, publikimi i thirrjes për vitin 2025 është shtyrë. Referuar pyetjes tuaj se kur do të shpallet thirrja e ekselencës për këtë, ju informojmë se do të shpallet brenda vitit 2026. Me shpalljen e thirrjes së ekselencës për vitin 2026, vlerësojmë gjithashtu të bëjmë me dije se të gjithë kandidatët që përmbushin kriteret e përcaktuara në VKM- në nr. 586, datë 30.08.2019, të ndryshuar, do të kenë mundësi të aplikojnë, duke përfshirë edhe ata që do të kishin qenë potencialisht përfitues në kuadër të thirrjes së vitit 2025.	E plotë	Nuk ka
4	02.03.2026	Kërkohet informacion nga një organizatë mbi procedura konkurrimi	09.03.2026	Përgjigja bashkëlidhur	E plotë	Nuk ka

5	02.03.2026	Kërkohet informacion mbi vijimin e një procedure konkurrimi	17.03.2026	Përgjigja bashkëlidhur	E plotë	Nuk ka
6	04.03.2026	Kërkohet informacion mbi testimet elektronike	19.03.2026	Përgjigja bashkëlidhur	E plotë	Nuk ka

7	09.03.2026	Kërkohet informacion mbi komandimin e një nëpunësi civil	27.03.2026	Përsëritje, Në lidhje me kërkesën tuaj sqarojmë sa vijon: Për pyetjet 1 dhe 2, të kërkesës suaj Bazuar në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike ka në kompetencë të tij të nxjerrë: Aktet e emërimit të nëpunësve civilë në përfundim të procedurave të konkurimit; Aktet e caktimit të anëtarëve të TND-së në një pozicion të rregullt të nivelit të lartë drejtues apo në pozicione të nivelit të mesëm drejtues, pas kërkesës së Kryeministrit apo ministrit, në sistemin e të cilit është vendi vakant. Aktet e pozicionimit të nëpunësve civilë të rikthyer nga pezullimi; Aktet e emërimit të nëpunësve civilë gjyqftues në zbatim të vendimit të formës së prerë të gjykatës; Aktet e transferimit të nëpunësve civilë, për një nga shkaqet e përcaktuara në legjislacionin për nëpunësin civil (ligji nr. 152/2013, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij). Nga sa më sipër, si dhe në vijim të sqarimit që ju kemi dhënë në korrespondencën e mëparshme (përgjigja e fundit në datën 18.03.2026) është e qartë që komandimi (ngarkimi me detyra) është një procedurë e brendshme e çdo institucioni dhe si e tillë nuk kryhet nga Departamenti i Administratës Publike, por nga vetë institucionet, të cilët as nuk kërkojnë miratimin dhe as e njoftojnë për këtë proces Departamentin e Administratës Publike. Për të gjitha sa më sipër, theksojmë se DAP-i nuk disponon asnjë dokumentacion në lidhje me komandimin e znj. L. Në lidhje me kërkesën e pikës 3, ju sqarojmë sa vijon: Në bazë të shpalljes publike për anëtarë të TND-së, znj. E. L. ka plotësuar kriterin e eksperiencës në pozicione të mesme drejtuese ose të barazvlefshme me to në institucione të administratës publike jashtë shërbimit civil.	E plotë	Nuk ka
8	24.03.2026	Kërkohet informacion mbi testimet elektronike	08.04.2026	Nuk disponohet informacion	Refuzuar	Nuk ka

9	30.03.2026	Kërkohet informacion mbi një nëpunës civil (E.L.)	14.04.2026	Përgjigja bashkëlidhur	E plotë	Nuk ka
10	11.04.2026	Kërkohet informacion mbi një proces legalizimi	27.04.2026	Jashtë kompetencës të institucionit, nuk disponohet informacion	E refuzuar	Nuk ka
11	30.04.2026	Kërkohet informacion mbi një nëpunës civil (E.D)	14.05.2026.	Përgjigja bashkëlidhur	E plotë	Nuk ka
12	11.05.2026	Kërkohet informacion mbi nëpunësin më të vjetër civil	22.05.2026	Përgjigja bashkëlidhur	Refuzuar	Nuk ka
13	11.05.2026	Kërkohet informacion lidhur me një ndërtim	22.05.2026	Jashtë kompetencës së institucionit	Refuzuar	Nuk ka
14	01.06.2026	Kërkohet informacion lidhur me zbatimin e një vkm-je për shtesat për ushqim	02.06.2026	Deleguar te ministria kompetente	Deleguar	Nuk ka

15	09.06.2026	Kërkohet informacion lidhur me një procedurë rekrutimi	15.06.2026	Në vijim të ankesës dhe kërkesës suaj lidhur me kodin nr. 7607-Drejtore i Drejtorisë së Vlerësimit, Mbikëqyrjes Shtetërore dhe Marrëveshjeve Ndërkombëtare, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, klasa e pagës II-1, ku kërkoni informacion për anulimin e procedurës së ngritjes në detyrë, për pozicionin e shpallur nga DAP ju bëjmë me dije se në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni për të drejtën e informimit, DAP ju vë në dispozicion dokumentacionin administrativ të disponuar dhe që lidhet me objektin e kërkesës suaj, konkretisht: Kopjen e email-it/kërkesës së AKSIK, mbi bazën e së cilës është kërkuar anulimi i procedurës së konkurrimit me kodin nr. 7607; Kopjen e Vendimit nr. 26, datë 05.06.2026 “Për deklarinimin të përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së konkurrimit për pozicionin: Drejtore i Drejtorisë së Vlerësimit, Mbikëqyrjes Shtetërore dhe Marrëveshjeve Ndërkombëtare, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, klasa e pagës II-1, kodi i shpalljes 7607”, të DAP. Lidhur me vënien në dispozicion të arsytimit të plotë ligjor, që ka çuar në anulimin e procedurës së konkurrimit si dhe informimin mbi bazën ligjore konkrete që justifikon anulimin e procedurës në këtë fazë të zhvillimit të saj, vlerësojmë se informacioni i kërkuar është pjesë përbërëse e Vendimit nr. 26, datë 05.06.2026 të DAP, të sipërcituar, të cilin do e gjeni bashkëlidhur. Gjithashtu bashkëlidhur do gjeni dhe komunikimin që DAP ka patur me institucionin e AKSIK lidhur me këtë procedurë. Si përfundim, ju sqarojmë se, kërkesa juaj për informim është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2026 të DAP-it, me numrin rendor 15, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tjetër për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al.	E plotë	Nuk ka
16	09.07.2026	Kërkohet informacion lidhur me kontrata shërbimi pastrimi	30.07.2026	Përgjigja Bashkëlidhur	E plotë	Nuk ka

17	09.07.2026	Kërkohet informacion lidhur me një nëpunës	30.07.2026	Përgjigja Bashkëlidhur	E plotë	Nuk ka
18	09.07.2026	Kërkohet informacion lidhur me një nëpunës	30.07.2026	Përgjigje Bashkëlidhur	E plotë	Nuk ka